

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **656-25-4978-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Pastrimi dhe mirembajtja higjenike e objektit të Komunes së Ferizajt dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunes së Ferizajt**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	" AROMA PLUS " SH.P.K.
NUI	601206908
Adresa	Bulevardi Nëna Terezë 2
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	045645088
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Mirvete Krasniqi
Adresa elektronike	shpk.aroma@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	12.07.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Pastrimi dhe mirembajtja higjienike e objektit të Komunes së Ferizajt dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuader të Komunes së Ferizajt

Njoftimi për kontratë i datës - 03.06.2025

Dosja e tenderit e datës - 03.06.2025

Sqarimi i dosjes së tenderit

Hapja e tenderit - 14.07.2025

Kërkesa për Rishqyrtim e datës – 08.07.2025

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 09.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për Rishqyrtim e datës – 08.07.2025

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 09.07.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e Autoritetit Kontraktues

Neni 1 – Qellimi

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim

Neni 27 – Dosja e tenderit

Neni 28 – Specifikimet teknike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të pa kënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 09.07.2025 ushtrojmë këtë:

ANKESË

Pretendimi nr.1

Kërkesa që lideri i grupit të përmbushë 60% të secilës kërkesë. Vendosja e këtij kufizimi për secilën kërkesë (jo vetëm për qarkullim financiar), është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ për Prokurimin Publik nr. 002/2024, i cili lejon këtë kufizim vetëm në rastet e qarkullimit financiar. Ky kufizim është diskriminues dhe zvogëlon pjesëmarrjen në aktivitetin e prokurimit.

Pretendimi nr.2

AK ka vendosur kërkesa të panevojshme për një numër të madh makinash pastruese tek kërkesa me nr 10.a) Operatori Ekonomik duhet të ketë të gjitha llojet e makinave për pastrimin e dyshemese dhe lustrimin 41 cope • Makine me ulëse me motor me gaz (LPG) për larjen dhe fshirjen e dyshemes, me kapacitet se paku 150L për ambiente të jashtme dhe të brendshme. Ta posedoj sistemin pastrim ekologjik pa detergjent (ec-H₂O) 1 cope • Karroce të madhe për pastrim të zyreve. Lideri i grupit duhet të përmbushë 60% të kërkesës. Edhe këtu AK ka paraqitur një kërkesë kufizuese duke kërkuar një

numër të madh të makinave për parstrimin e dyshemes prej 41 copë, përveç kësaj ka kërkuar që të posedoj sistemin e pastrimit ekologjik pa detergjent (ec-H₂O) një copë, dhe poashtu edhe lideri të ketë 60% të kërkeses. Siç shihet këto janë kërkesa kufizuese e sidomos kërkesa “Ta posedoj sistemin pastrim ekologjik pa detergjent (ec-H₂O) 1 cope” pasi një pajisje e tillë është e shtrejtë dhe e rrallë mund të posedohet vetëm nga një kompani e caktuar dhe me këtë AK ka kufizuar plotësisht konkurrencën. Andaj kërkojmë që të eliminohen nga dosja e tenderit dhe të vendosen kërkesa në përputhje me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi nr.3

Poashtu edhe tek kërkesa me nr 7.Operatori Ekonomik duhet te posedoj me se paku 10 Automjete per nevojat e furnizimit, OE mund te ofrojne edhe marreveshje me nje kompani per shfrytezimin e veturave (Rent a Car), kompania duhet te jete e regjistruar si veprimtari per dhenien e veturave me qera pra Rent a Car (valide). Lideri i grupit duhet te permbush 60% te kerkeses. Edhe në këtë rast AK ka paraqitur kërkesë diskriminuese apo kufizuese për shkak se ka kërkuar që lideri të ketë 60% të kërkeses së dosjes të cilën e kemi spejuar më lartë.

Përfundimisht, konsiderojmë se kërkesat e lartpërmendura janë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, që garanton parimin e mosdiskriminimit dhe të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, dhe kufizojnë në mënyrë të pajustificuar konkurrencën në këtë aktivitet të prokurimit publik.

Pretendimi nr.4

Kërkesa nr 8.Operatori Ekonomik duhet te kete raportin e vleresimit te riskut te kompanise leshuar nga; a) organet (institucioni) pergjegjese ose nga ndonje kompani e licencuar per vleresim te riskut tekompasive. b) te posedoj minimum 8 punetor te certifikuar per siguri dhe shendet ne pune dhe mbrojtje nga zjarri sipas orgranogramit te kompanise. c) operatori ekonomik duhet te caktoj me vendim menaxherin e kontrates si dhe i njejti duhet te jete i certifikuar per menaxhimin e riskut sipas standardeve ISO, i njejti duhet tekete pervoj pune min.3 vite si dhe ti bashkangjitetdiploma e shkolles se mesme. Lideri i grupit duhet te permbush 60% te kerkeses.

Kërkesa nr 9.Operatori Ekonomik duhet te posedojminimumin 8 punetor(staff) te certifikuar ose edhe te licencuar per perdorimin e aparateve kunder zjarrit (zjarrefikjes)! Kërkesa bazohet edhe ne objektet e shumta qe i posedon Komuna e Ferizajt. Lideri i grupit duhet te permbush 60% te kerkeses.

Siç e kemi spjeguar edhe me larte, se kufizimi i 60 % nga lideri për secilen kërkesë të dosjes së tenderit, janë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-se paraqesin zvoglim të konkuresncës, poashtu është kriter i paçartë sepse nuk dihet sakt numeri i punëtorëve a kërkojnë vetëm 8 persona të certifikuar me të gjitha llojet e çertifikatave, apo duhet të jetë numeri minimal i punëtorëve 24 punëtor të certifikuar secili në vetëm fushën përkatëse

Pretendimi nr.5

Lidhur me aktivitetin e prokurimit “ *Pastrimi dhe mirembajtja higjenike e objektit te Komunes se Ferizajt dhe institucioneve tjera qe funksionojne ne kuader te Komunes se Ferizajt*” me nr te prokurimit me nr te prokurimit 656-25-4978-2-1-1, KRPP me dt 25.06.2025 ka leshuar rekomandim permes te cilit ka vertetuar se kriteret e vendosura ne njoftim per kontrate dhe ne dosjen e tenderit jane diskriminuse dhe zvoglojn konkurencen. Bazuar ne kete vertetohet fakti se pretendimet tona ne kete kerkese per rishqyrtim kane qene te bazuara pavaresisht kesaj AK nuk ka marre per baze as kerkesen tone per rishqyrtim e me keq se kaq as rekomandimin e leshuar nga KRPP andaj nuk kemi si te mos mendojme se AK, keto kriteret i ka vendosur per Operatore Ekonomik te caktuar dhe se paraqesin diskriminim, kufizim dhe jo proporcionalitet me aktivitetin e prokurimit te inicuar nga AK. Kerkojme nga Paneli Shqyrtues qe te merren masa ndaj zyrtarit te prokurimit i cili ka bere shkelje dhe nuk e zbatuar rekomandimin e KRPP-se.

Te bashkangjitur gjeni rekomandimin e KRPP-se.



Të nderuar,

Në bazë të Nenit 88 të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092, si dhe në pajtim me Rregulloren e punës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), ka kompetencë për të vëzhguar dhe mbikëqyrur zbatimin e dispozitave të LPP-së dhe rregullave të nxjerra nga KRPP, në të gjitha Autoritetet Kontraktues në Kosovë.

Mbi këtë bazë lidhur me Aktivitetin e Prokurimit me Titull:” Pastrimi dhe mirembajtja higjienike e objektit të Komunes së Ferizajt dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuader të Komunes së Ferizajt” me nr.Prok:656-25-4978-2-1-1 vlerë të parashikuar 2,000,000.00 €– publikuar në platformën e E-prokurimit dhe iniciuar nga autoriteti kontraktues- **KOMUNA FERIZAJ**. KRPP ka monitoruar njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit ku keni specifikuar Te pjesa III.2.4).Kapaciteti teknik dhe profesional: Te kërkesat sipas standardeve ndërkombetare të menaxhimit të cilësive në lemin e pastrimit të objekteve, me ISO Certificate 9001 2015 (valide). b) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombetare të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në leminë e pastrimit të objekteve OHSAS ISO Certificate 45001 2018 (valide). c) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombetare të menaxhimit të informacionit, në leminë e pastrimit të objekteve ISO Certificate 27001 2013 (valide). Kërkesa 3.Certifikata e akreditimit të kompanisë certifikuese.

2.Operatori Ekonomik duhet të posedoj minimumin (8) punëtor(staff) të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë në përputhshëri me Ligjin Nr.04 L-161 sipas organogramit të kompanisë. Lideri i grupit duhet të përmbush 60% të kërkesës.

. b) të posedoj minimum 8 punëtor të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri sipas organogramit të kompanisë.

3. Ta posedoj sistemin pastrim ekologjik pa detergjent (ec-H₂O) 1 cope
Materiali i përdorur duhet të jetë ekologjik dhe i shoqëruar me dokumentin përkatës MSDS (material safety data sheet)

Departamenti i Monitorimit në KRPP bazuar në konstatimet si më lartë lëshon këtë:

Rekomandim

Te pika III.2.4)) Kapaciteti teknik dhe profesional. AK-Komuna Ferizaj.Te pikat ku keni kërkuar Certifikatat sipas standardeve ndërkombetare të menaxhimit të cilësive në lemin e pastrimit të objekteve, me ISO Certificate 9001 2015 (valide). b) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombetare të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në leminë e pastrimit të objekteve OHSAS ISO Certificate 45001 2018 (valide). c) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombetare të menaxhimit të informacionit, në leminë e pastrimit të objekteve ISO Certificate 27001 2013 (valide). Kërkesa 3.Certifikata e akreditimit të kompanisë certifikuese.

KRPP-Rekomandon AK-në të rishikoi këto kërkesa sepse mund të parqesin kufizim apo favorizime potenciale për OE të caktuar e cila bie ndesh me nenin 7.2 të LPP-së i cili thotë "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik"

Po ashtu KRPP -vleron se AK me rastin e vendosjes së Kërkesave kualifikuese konform nenit 25.6 Rregullores për Prokurim Publik ,mund të kërkoj vetëm kërkesat minimale dhe në proporcion me lëndën e AP dhe vetëm ato kërkesa të cilat janë ngushte të lidhura me AP dhe sigurimin e cilësisë të mbetën si kërkesa certifikata që nuk ka asnjë lidhshmëri në sigurim të cilësisë të largohet.

2.). b) Operatori duhet të jete i certifikuar sipas standardeve nderkombetare të menaxhimit të shendetit dhe sigurise ne pune.Operatori Ekonomik duhet të posedoj minimumin (8) punetor(staff) të certifikuar për siguri dhe shendet ne pune ne perputhshmeri me Ligjin Nr.04 L-161 sipas organogramit të kompanise. Lideri i grupit duhet të përmbush 60% të kërkeses.b) të posedoj minimum 8 punetor të certifikuar për siguri dhe shendet ne pune dhe mbrojtje nga zjarri sipas organogramit të kompanise.Andaj nëse AK e sheh të nevojshme, atëherë kërkesat me ISO Standard duhet të kërkojen në emër të kompanis dhe jo si në rastin konkret ku keni kërkuar edhe për punëtor pasi që kërkesat e tilla kufizojnë konkurrencen e lirë dhe bien ndesh me nenin 7.2 të LPP-së si dhe ligjin të cilin jeni thirrur nr. 04L-161. konkretisht në neni 9,10 dhe 11 i këtij ligji.

3. Te kërkesat për makineri keni kërkuar ta posedoj sistemin pastrim ekologjik pa detergjent (ec-H2O) 1 cope

Materiali i përdorur duhet të jete ekologjik dhe i shoqëruar me dokumentin përkatës MSDS (material safety data sheet) -AK të rishikoi këto kërkesa sepse mund të parqesin kufizim apo favorizime potenciale për OE të caktuar e cila bie ndesh me nenin 7.2 të LPP-së i cili thotë "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik"

Sipas kësaj kërkojmë nga Zyra e prokurimit në **Komunen e Ferizajt** të ndërmerr veprime për evitimin e këtyre gjetjeve, si dhe përmes veglës së monitorimit në e-prokurim të njoftohet KRPP përkatësisht dep – monitorimit për veprimet rreth adresimit të këtyre rekomandimeve.

Me respekt
Dp i Monitorimit
Dt: 25.06.2025

Kjo shkresë dërgohet si rezultat i procesit të Monitorimit dhe për qëllim të evitimit të gjetjeve për aktivitetin e prokurimit si më lartë e cila mund të ketë qasje dhe mund të përdoret vetëm nga pala që i adresohet. Andaj nuk mund të kopjoni ose të bëni publike përmbajtjen e saj apo dërgoni të palët e treta pa lejen e autorit apo departamentit të Monitorimit në Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik në Kosovë sepse një veprim i tillë ndalohet dhe do të rezultojë me veprime ligjore sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Ne kërkojmë nga OSHP që të anulojë këto kritere kufizuese dhe të obligojë Autoritetin Kontraktues të rishikojë dosjen e tenderit duke e harmonizuar atë me LPP-në dhe udhëzimet administrative përkatëse, dhe të merret ky:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik : ‘‘Aroma Plus’’ SH.P.K. ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: ‘‘ Pastrimi dhe mirembajtja higjenike e objektit te Komunes se Ferizajt dhe institucioneve tjera qe funksionojne ne kuader te Komunes se Ferizajt’’ me nr te prokurimit me nr te prokurimit 656-25-4978-2-1-1, te iniciuar nga Komuna Ferizaj.

KORRIGJOHET Dosja e tenderit për procedurën e prokurimit me titull ‘‘ Pastrimi dhe mirembajtja higjenike e objektit te Komunes se Ferizajt dhe institucioneve tjera qe funksionojne ne kuader te Komunes se Ferizajt’’ me nr te prokurimit me nr te prokurimit 656-25-4978-2-1-1, iniciuar nga Komuna Ferizaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

500

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të ‘‘Njoftimit për Kontratë’’ apo ‘‘Njoftimit për Konkurs të Projektimit.’’*
- b) një kopje të publikimit për ‘‘Njoftimin e Dhënies së Kontratës’’ apo ‘‘Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit’’ apo ‘‘Njoftimit për Anulim’’.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*